



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:067879
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876230

KPPP.nr.530/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.SH. Rent Smart, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Isa Salihi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” Sh.A., me seli në rr. “Lagjja Kalabria”, Blloku B1, nr. 5, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.300/20 të datës 13.03.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura në çështjen përmbartimore në mes të kreditorit N.T.SH. Rent Smart, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” Sh.A., e lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.300/20 të datës 13.03.2020, të Përmbartuesit Privat Eset Murati, për shkak të fillimit të likuidimit të detyrueshëm ndaj të debitorit.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr.300/20 të datës 13.03.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin mbi bazën e dokumentit përmbartimor - aktgjykimit me shenjë I.EK.nr.387/15 të datës 30.11.2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i formës së prerë me datë 06.06.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 05.07.2019, ashtuqë të detyrohet debitori që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrit, t'i paguaj kreditorit shumën prej 9,731.00 € në emër të kompensimit të dëmit me kamatë ligjore

vjetore 12% nga data 31.08.2015 e deri në pagesën definitive, shpenzimet procedurale në lartësi 414.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm me përbarimin e mjeteve monetare në llogaritë bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të përbaruesit privat, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe përmbushjen e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e sendeve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se me datë 16.10.2019 ka paguar këstin e parë në shumën prej 4,874.82 €, ndërsa dy këstet e tjera do të paguheshin deri në fundin e muajit Mars 2020, ashtu që ekzekutimi i shpejtë nga ana e përbaruesit privat do të çrregullonte sistemin e pagesave dhe do të bëheshin vonesa të tjera për të gjitha lëndët. Ka shtuar se është i vetëdijshëm për obligimin e tij dhe se arsyeja e shtyrjes së pagesës për disa ditë është për shkakun e bllokimit të llogarive bankare. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për caktimin e përbarimit dhe të shtyhet urdhri përbarimor.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, duke deklaruar se nuk mbështetet në prova të duhura siç parashihen me ligj. Në lidhje me pretendimet e debitorit se me kreditorin janë marr vesh që pagesa të bëhet deri në fundin të muajit Mars 2020, e njëjta nuk qëndron dhe se edhe pas kësaj date nuk është bërë asnjë pagesë nga pala debitore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, si dhe ka kërkuar shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 156.00 € sipas TOAK.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, në bazë të kompetencës lëndore është transferuar për vendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, lidhur me këtë çështje juridike përbarimore zyrtarisht është informuar që debitori Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” Sh.A., sipas vendimit nr. 70-24/2021, të datës 24.09.2021 të lëshuar nga Banka Qendrore të Kosovës, i është nënshtruar procedurës së likuidimit të detyrueshëm.

Prandaj, gjykata në mbështetje të nenit 277, pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), i cili gjen zbatim përshtatshmërisht në këtë çështje përbarimore në

përputhje me nenin 17 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: “*Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues*”, vlerëson se procedura në këtë çështje juridike duhet të ndërpritet për shkak se debitori sipas vendimit nr. 70-24/2021, të datës 24.09.2021, të lëshuar nga ana e BQK-së, i është nënshtruar procedurës së likuidimit të detyrueshëm dhe tani ka cilësinë e debitorit në falimentim.

Nga sa më sipër, konform nenit nenit 17 të LPP-së në lidhje me nenin 277, pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.530/22, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.